



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 1.12.2014, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Qendron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemi Veseli (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinofci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Besa Rafuna (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

Munguan: Vjollca Dibra – Ibrahim (LDK), Sadri Ramabaja (LVV), Muhamet Selmani (PDK), Hasime Krasniqi (LDK) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillonin diskutimet lidhur me rendin e ditës, **Kryetari** propozoi që edhe një herë të bëhet një votim formal për të njëjtin vendim - *Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2014*, në fakt të votohet për dy vendime.

Sami Hamiti propozoi që pika e katërt e rendit të ditës, të jetë e para për diskutim. Rreth rendit të ditës diskutuan edhe Ylli Hoxha, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Agim Gashi, Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Shemsi Veseli dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Me propozimin e Kryetarit dhe të z. Hamiti, kryesuesi konstatoi se u miratua ky

R E N D I D I T Ë S:

- 1. Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror 2014- 2015;**
- 2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit;**
- 3. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015;**
- 4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë;**
- 5. Propozimrregullorja për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme;**
- 6. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi;**
- 7. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit për hapjen e kutive të ankesave;**
- 8. Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetor për vitin 2014;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**
- 10. Të ndryshme.**

Pika e parë

Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror 2014-2015.

Kryesuesi e ftoi z. Arsim Janova, kryeshef ekzekutiv i NPL “Termokos”, të informojë lidhur me fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror 2014 - 2015.

Zotëri Janova i njoftoi të pranishmit rreth përgatitjeve për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror, si dhe për finalizimin e projektit të kogjenerimit. Njëherësh informoi edhe për disa çështje të tjera që ndërlidhen me funksionalizimin e ngrohtores. Diskutimi i z. Janova është dhënë i plotë në transkript.

Për këtë çështje diskutuan: Islam Pacolli, Ylli Hoxha, Kreshnik Ahmeti, Shaip Hajrizi, Visar Arifaj, Agim Gashi, Shemsi Veseli, Sylejman Pireva, Shefki Gashi, Flamur Shala, Lirak Çelaj, Hatixhe Pupovci, Ajnishahe Azemi, Shpend Ahmeti, Qendron Kastrati dhe Imer Rusinovci. Diskutimet janë dhënë të plota në transkript.

Lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe shqetësimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Arsim Janova**, kryeshef ekzekutiv.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror 2014-2015.

Pika e dytë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit.

Sylejman Pireva bëri vërejte në ekstrakt, duke thënë se nuk po tregohet kujdesi i mjaftueshëm në besnikërinë dhe cilësinë, në profesionalizmin se si mbahet një procesverbal, prandaj konsideroj se duhet të ketë korrigjime dhe përmirësime të dukshme. **Feti Mehdiu** vërejtje bëri në pikën e trembëdhjetë, duke cekur se është dashtë të nxirret nga transkripti dhe të paraqitet në ekstrakt shqetësimi që u shfaq në këtë Kuvend për informatën e arsimit.

Qëndron Kastrati vërejtje bëri në pikën e dymbëdhjetë, duke shtuar se në formën se si është nxjerrë pjesërisht konkluzioni, nuk qëndron, sepse disponimi ishte për hapësirë gjelbëruese më të madhe. Përveç kësaj, ishte propozim që, së pari, Komuna ose ekzekutivi ta parasheh çmimin, vlerën financiare të shpronësimit dhe njëkohësisht me ardhur për diskutim në raport me vlerën që duhet bërë.

Sofije Bunjaku bëri vërejtje në pikën e trembëdhjetë të ekstraktit. Ajo tha se nuk janë cekur gjërat shqetësuese që kanë të bëjnë me cilësinë në arsim.

Bekim Gashi, paraqiti vërejtje për mos cekjen e emrit të tij lidhur me diskutimin për stadiumin në fshatin Hajvali.

Sami Hamiti, edhe kësaj radhe ngriti çështjen e procesverbalit, me ç'rast theksoi se më herët, para dy mbledhjeve, u pajtuam që ekstrakti i procesverbalit të jetë shumë i shkurtër, ta përfshijë thelbësoren çka është vendosur, prandaj secili nga anëtarët e ka edhe transkriptin. Secilën herë ne kemi folur se ai ekstrakt duhet t'i ketë 2-3 faqe, edhe unë mendoj që duhet t'i ketë vetëm shënimet kryesore, sepse është ekstrakt dhe transkriptin, i cili i përmban të gjitha diskutimet e plota, e merr secili prej nesh dhe e sheh.

Kryesuesi edhe një herë e përsëriti se në ekstrakt shkruhen konkluzionet, vendimet dhe ndonjë diskutim që qon në marrjen e atij vendimi, kështu që ekziston transkripti, megjithatë edhe sekretaria duhet të jetë më e kujdesshme.

Kryesuesi konstatoi se, me vërejtjet dhe plotësimet e dhëna, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës.

Pika e tretë

Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015.

Kryesuesi propozoi që në këtë grup punues të jenë edhe Agim Salihu dhe Osman Bllaca, këshilltar i Kryetarit.

Ylli Hoxha propozoi që në vend të tij të jetë Sylejman Pireva.

Kryesuesi konstatoi se, me propozimet e dhëna, njëzëri u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015.

Pika e katërt

Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë.

Lidhur me propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë, arsyetimin e paraqiti **Libur Aliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shiqeri Spahiu, në emër të GP të LDK-së, tha se pronës e cila është objekt këmbimi në Zonën kadastrale Çagllavicë, i mungon certifikata e pronës dhe kopja e planit, por edhe materiali që na është dorëzuar vështirë mund të lexohet, posaçërisht hartat kadastrale, andaj sugjeroj që në të ardhmen, materialet e tilla të jenë më cilësore dhe më të lexueshme. Arsyetimi nuk është mjaft cilësor, por ka edhe diferencë rreth sipërfaqeve në metra katrorë etj.

Si GP e përkrahim, në parim e përkrahim çdo iniciativë që rregullon çështjet komunale pronësore për të realizuar projektet, por paraprakisht kërkojmë dhe shpresojmë që do të na jepen qartësime ndaj këtyre çështjeve dhe dilemave të tjera.

Qëndron Kastrati, në emër të LVV-së, theksoi se në parim jemi për zgjidhjen e dy propozimeve, njëri rast është për realizimin e një rruge dhe rasti tjetër është për park.

Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, shprehu përkrahje në parim për këtë pikë, duke pasur parasysh që është për interes publik. Ai shfaqti dilemë për këtë pronë të Komunës që po këmbehet, se aty ekzistonte një ndërtim, por në fotot kadastrale nuk figuron. Po ashtu edhe në rastin tjetër në Çagllavicë, me rastin e kompensimit mendohet të bëhet një rrugë jo e drejtë, ashtu si ka qenë, prandaj kërkoj që mundësisht ajo të jetë e drejtë.

Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së, tha se në parim e përkrahim, por kërkojmë të dhëna shtesë për sqarim. Plotësisht e përkrah propozimin e parafolësit, z. Çelaj, që projektimi i rrugëve të bëhet në vija të drejta.

Imer Rusinovci, shef i GP të AAK - LDD-së, theksoi se lidhur me këto kompensime kemi pak shqetësime, sepse kjo është konform legjislacionit, andaj në këtë drejtim duhet dhënë një shpjegim pak më i detajuar nga Zyra ligjore, për faktin se të gjithë jemi dëshmitarë që këtë tokë bujqësore që e kemi, është në ndërtim e sipër.

Si GP e përkrahim, po që se marrim shpjegime lidhur me këto që u cekën.

Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, e përkrahu propozimvendimin, me sugjerimin që drejtoria përkatëse t'i analizojë dhe t'i shqyrtojë mirë, sepse ka raste kur janë bërë disa ndryshime më herët, dhe pasi është bërë rregullimi, pas 2 vitesh, prapë është korrigjuar.

Ibrahim Mehmetaj, shef i GP të LB-së, e përkrahu në parim propozimvendimin, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projekti.

Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, theksoi se e përkrah propozimvendimin, me sugjerimin që në të ardhmen materialet të dërgohen në forma të tjera, pasi që qasja në materialet e skanuara është tejet e vështirë.

Lidhur me këtë pikë diskutuan edhe Shefki Gashi, Laura Zherka, Agim Salihu, Shemsi Veseli, Liburn Aliu, Flamur Shala, Sami Hamiti dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas përfundimit të diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin e parë, për këmbimin e pronës në Zonën kadastrale Çagllavicë.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash, tridhjetë e tri (33) për, gjashtë (6) kundër dhe një (1) abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën në pronësi të personit fizik, Zona kadastrale Çagllavicë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dytë.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash, tridhjetë e katër (34) për, gjashtë (6) kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën në pronësi të personit fizik, Zona kadastrale Matiçan.

Pika e pestë

Propozimrregullorja për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme.

Kryesuesi kërkoi nga shefi i Zyrës ligjore, z. Agim Salihu, të bëjë një paraqitje të shkurtër lidhur me Propozimrregulloren për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme.

Propozimrregullorja u përkrah për miratim nga të gjitha grupet parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimrregullorja për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi ia dha fjalën z. Agim Salihu, të paraqesë arsyetimin për ndryshimin e këtij vendimi. Ndër të tjera, ai tha se z. Osman Bllaca ka kaluar në punë dhe detyra të tjera, andaj duhet të zëvendësohet, dhe mbetet të jepet propozimi nga anëtarët e Kuvendit.

Genc Sherifi, për anëtar të Këshillit për Siguri në Bashkësi, propozoi z. Kristian Hasanaj, përfaqësues nga OJQ-të.

Bekim Gashi propozoi z. Ganimet Klaiqi, përfaqësues nga OJQ-të.

Lirak Çelaj dhe Ylli Hoxha shprehën rezervë në mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve.

Flamur Shala propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, për shkak se të propozuarit janë në konflikt interesi.

Për këtë pikë diskutuan edhe Dardan Sejdiu, Shefki Gashi, Agim Salihu dhe Kreshnik Ahmeti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se, duke pasur parasysh rrjedhën e diskutimeve, Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi, shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit për hapjen e kutive të ankesave.

Kryesuesi ia dha fjalën z. Agim Salihu, për ta paraqitur arsyetimin lidhur me caktimin e anëtarëve të këtij komisioni.

Sami Hamiti, për anëtar të komisionit propozoi z. Bekim Gashi (LDK).

Ylli Hoxha, për anëtar të komisionit propozoi z. Genc Sherifi (LVV), ndërsa për anëtar nga Shoqëria Civile propozoi z. Kristian Hasanaj.

Lirak Çelaj, për anëtare të komisionit propozoi znj. Lirije Avdiun (PDK). Njëherësh kërkoi që për anëtarët nga Shoqëria Civile, të shihet mundësia që të dihet se cilat janë organizatat e regjistruara. Pra, Shoqëria Civile le t'i paraqesë përfaqësuesit e saj për të gjitha komisionet në të cilat propozohen, dhe më pas të diskutohen dhe të shqyrtohen për miratim.

Ylli Hoxha shprehu mendimin se propozimi i tillë nuk qëndron, andaj propozoi që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim për seancën e radhës.

Visar Arifaj propozoi znj. Lirije Avdiu për anëtare të këtij komisioni.

Kryesuesi, duke pasur për bazë diskutimet, konstatoi se Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit për hapjen e kutive të ankesave, shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetor për vitin 2014.

Shpend Ahmeti, paraqiti arsyetimin për rivotimin e këtij vendimi.

Njëzëri u miratua Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2014.

Pika e nëntë

Pyetje dhe përgjigje.

Sami Hamiti: Në pajtim me dispozitat e nenit 39 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe të nenit 41 të Statutit të Komunës, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi nga Kryetar i Komunës, z. Shpend Ahmeti, këto informacione: Numrin e të punësuarve, sa janë punësuar me konkurs nga 1 janari deri në fund të nëntorit të këtij viti, sa janë me kontratë për kryerjen e punëve, sa janë praktikantë, sa janë me punë vullnetare, sa është numri i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe numri i ekzekutimit të këtyre vendimeve?

Kërkoj që në afatin prej 15 ditësh, të na jepet përgjigje.

Sokol Krasniqi: Në bazë të Ligjit për lojërat e fatit, kërkoi që të shqyrtohet mundësia e mbylljes së njëmbëdhjetë lokaleve të lojërave të fatit, që janë hapur brenda gjashtë muajve në rrugën "Haxhi Zeka", të cilat korrespondojnë me shkelje të ligjit. Kërkoj që kjo të shikohet, në bashkëpunim me ATK-në, se është një kërkesë imediate, d.m.th. e të gjithë njerëzve të cilët jetojnë në atë rajon. Po ashtu, kërkoi që të merren masa sa më urgjente për

ndalimin e hedhjes së mbeturinave të ngurta dhe mbeturinave të tjera shtazore pranë rrugës Kolovicë – Butoc, hapësirë e cila është shndërruar në deponi të mbeturinave.

Agim Gashi: Sipas informatave që kemi, komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve të ndryshme në Prishtinë, kanë filluar të bëjnë shkarkimin e bordeve të drejtorëve pa iu kaluar kontrata e tyre. Bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike, nr. 03-L-087, neni 7, pika 3, komisionet e aksionarëve janë të obliguara ta njoftojnë Kuvendin lidhur me vendimet e tilla. Një gjë e tillë deri sot nuk është bërë, prandaj për këtë çështje kërkoj sqarime të mëtejme.

Remzi Pacolli, Bashkësia Lokale e Hajvalisë e ka shqyrtuar parcelën me nr. 601/0, për ndërtimin e varrezave të fshatit, dhe nga Ministria përkatëse kërkon që ta bëjë verifikimin e saj se a lejohet përcaktimi i kësaj parcele për varreza sipas Planit zhvillimor. Kërkoj sqarim nga drejtoria përkatëse se pse nuk po përdoret vula në BL-në e Hajvalisë. Në pjesën e sipërme të fshatit Hajvali, në drejtim të liqenit të Badocit, është hedhur një sasi e madhe e mbeturinave inerte, andaj kërkoj nga Drejtoria e Inspektionit që ta bëjë kontrollimin e asaj zone.

Shiqeri Spahiu: Pyetjen rreth “policëve të shtrirë” apo pengesave në rrugë:

- A ka pasur projekt të hartuar paraprakisht për ekzekutimin, gjegjësisht vendosjen e këtyre pengesave?
- Nëse po, cila kompani ose organ i ka hartuar këto projekte?
- Cilat standarde janë aplikuar në hartimin dhe dimensionimin e projekteve të tilla?
- Cila kompani ka bërë ekzekutimin e tyre, a i është përmbajtur projektit dhe mënyrës së ekzekutimit të tyre?
- A ka pasur organ mbikëqyrës dhe çfarë ka qenë konstatimi i tij, a ka pasur kontrollim, gjegjësisht pranim teknik, kush i ka bërë dhe çfarë konkluzioni ka bërë ky komision?
- A është duke u zbatuar sipas projektit vazhdimi i rrugës “Enver Maloku”, a ka ndryshime eventuale gjatë zbatimit dhe, nëse po, ku janë ato ndryshime?
- A do të realizohet sipas planit rrethrotullimi në pjesën ku takohet me rrugën “Muharrem Fejza” dhe në krahun e djathtë me rrugën “Enver Maloku”, kur është marr ky vendim dhe nga cili organ?

Lirijeta Rexhepi: Shtroj pyetjet në vazhdim:

- A është në plan zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës tek semafori në lagjen “Velania”?
- A është në plan vazhdimi i ndriçimit të rrugëve nëpër fshatrat e komunës së Prishtinës, posaçërisht projekti i ndriçimit të rrugës në fshatin Tenezhdoll, dhe ky projekt a do të përfundojë gjatë këtij viti?
- A do të bëhet asfaltimi i një segmenti rrugor afër shkollës fillore “Xhavit Ahmeti”, në lagjen “Vreshtat”?

Hatixhe Pupovci paraqiti kërkesën e organizatës “Hendikep Kosova”, duke cekur se kjo organizatë ka kërkuar për shfrytëzim një pronë komunale, dhe kërkoi që kjo të futet në rend dite dhe të shqyrtohet kërkesa e tyre, sepse ata kishin bërë kërkesa edhe më herët në Komunën e Prishtinës. Duhet gjetur mënyra për t’i ndihmuar kësaj organizate, meqenëse merret me persona me nevoja të veçanta.

Lidhur me këtë kërkesë, **Shpend Ahmeti** dhe **kryesuesi** dhanë sqarime të nevojshme.

Bekim Gashi, kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale:

Banorët e një pjese të fshatit Hajvali kanë një shqetësim, që ka të bëjë me kundërmimin e ujërave të zeza, dhe kërkojnë që në vitin e ardhshëm, me prioritet të trajtohet ndërtimi i kolektorit nga Pallati i Drejtësisë deri te objekti i ndërmarrjes “Koha Ditore”.

Po ashtu kërkojnë nga Shërbimi i inspektionit që me kohë të marrë masat për mbylljen e lojërave të fatit, që janë jashtë parametrave të paraparë sipas Ligjit për lojërat e fatit.

Ylli Hoxha shtroi pyetjen rreth Planit rregullues të lagjes “Sofalia”, duke shprehur dilemën se si ka qenë e mundur që prona e rripit të gjelbër të Gërmisë, e cila në vitet e 70 - 80-ta ka qenë pronë komunale e eksproprijuar, është kthyer në masë të madhe në pronë private.

- Cila ka qenë procedura ligjore, cilët kanë qenë hapat e Komunës në mbrojtje të asaj prone?

Pra, na duhet një interpretim ligjor përkitazi me këtë çështje, sepse na ka kaluar në Asamble, e kemi shtruar si dilemë, si çështje, dhe duhet një përgjigje me shkrim.

Lirak Çelaj, pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit:

Sipas informacioneve nga Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor, rreth tarifave, pagesave për ndërtim, afati për të aplikuar dhe për të paraqitur shkallën e këtyre tarifave ka qenë tetori, dhe kjo gjë nuk është zbatuar nga Komuna.

Nëse hyjmë në vitin tjetër pa miratimin e këtyre tarifave nga Qeveria, a nënkupton që do të jetë vjelje e jashtëligjshme e këtyre tarifave, a do të respektoni uljen e tarifave siç sugjeron kjo Ministri, për të cilën unë mendoj se duhet të ulen tarifatat, për shkak se mund të ulet edhe çmimi i banesave dhe do të përfitojnë qytetarët?

Shemsi Veseli, pyetje dhe kërkesa:

Kërkoj publikimin e kontratës së nënshkruar nga ekzekutivi i Komunës së Prishtinës me Kardiokirurgjinë Dalladaku, ku dhe tani kemi të bëjmë me kërkesa të Spitalit Amerikan rreth ridestinit të kësaj qendre spitalore.

Kërkoj publikimin e kontratës me klubin “Prishtina”, kur dihet se si aksionar në këtë klub janë edhe disa qytetarë të Prishtinës. Lidhur me këtë shtoj pyetjen:

- A arkëtohen mjetet për lokalet që janë aty, kush i merr ato mjete, çka ndodh me to etj.?

Kërkoj publikimin e kontratës me Kompaninë “Jeta”, për garazhet publike te QKUK-ja, në mënyrë që të dimë se çfarë ndodh aty.

Lidhur me caktimin e lokacionit të Institutit të Varshmërisë, duke pasur parasysh numrin e madh të të rinjve që janë të varur nga droga dhe gjërat tjera, jemi të interesuar, bashkërisht me Komunën e Prishtinës edhe Ministria, me e bërë një Institut, ku do të trajtohen dhe shërohen ata fëmijë apo persona të varur nga droga.

- A ka vendime për shfrytëzimin e pronave në mes Fushë-Kosovës dhe Prishtinës, nëse ka, kush i ka nënshkruar dhe kush ua ka vazhduar, nëse janë të vazhduara?

Kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit që për disa qytetarë, të cilët kanë aplikuar për leje ndërtimi në vitin 2011 apo 2012, të rishikohen edhe një herë ato kërkesa, pasi që, sipas disa informacioneve, thuhet se ato leje janë anuluar.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Veseli rreth rishikimit të disa lejeve të ndërtimit gjatë periudhës së vitit 2011- 2012, sqarime të nevojshme dha **Liburn Aliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Islam Pacolli kërkoi sqarim nga Kryetari, duke thënë se a mundemi me e marrë një vendim në Kuvendin komunal për mbylljen e lokaleve të kazinove në fshatin Hajvali, pasi që ato janë duke i sjellë një dëm të madh rinisë së fshatit.

Merita Surkishi, paraqiti kërkesën e banorëve afër rrugës “Zef Pëllumbi”, në lagjen “Kodra e Trimave”, ku thuhej se në këtë lagje nuk e kanë të ndërtuar kanalizimin dhe rruga është e pa asfaltuar, ku si pasojë gjatë sezonit të dimrit këta banorë kanë vështirësi në qarkullim.

Vërejte bëri edhe rreth pengesave në rrugë, të ashtuquajtur “polic i shtrirë në rrugën” nga Hani i Dilit deri te rruga “Vëllezërit Fazliu”, pasi që ato janë shumë të lartë dhe pengojnë zhvillimin e rregullt të komunikacionit.

Mustafë Krasniqi tha se me një vendim të këtij Kuvendi, ne kemi ndarë një shumë prej 50.000 € për sanimin dhe kompensimin e dëmeve që janë shkaktuar si pasojë e vërshimeve, prandaj dua të dijë se a ka filluar ndarja e mjeteve dhe sa janë sanuar ato dëme, nëse janë sanuar çoftë rrugë, ura etj., dhe a janë kompensuar pronarët që pësuan nga këto vërshime.

Sylejman Pireva theksoi se në anën e djathtë të rrugës “B” (drejtimi poshtë për në qytet), gjenden disa objekte që janë nga periudha e socializmit, ku aty janë disa kasolle, të cilat më shumë po shërbejnë si wc publike. Lidhur me këtë shtroi pyetjen:

- A mund të bëhet ndonjë planifikim që të hiqen ato objekte, apo të renovohen dhe të përdoren për ndonjë qëllim të mirëfilltë?

Kreshnik Ahmeti njoftoi se tifozët e klubeve të Prishtinës (Plisat), tash e një kohë të gjatë janë pa lokal. Hapësirën të cilën e kanë shfrytëzuar para një kohe në atë stadium, e përdor dikush tjetër për të hyra të veta dhe nuk ka të bëjë aspak me Plisat. Kërkoj që të bëhet një zgjidhje për këta tifozë.

Shaip Shabani, shtroi pyetjen për Kryetarin:

- A jeni në dijeni për shkollën e fshatit Ballaban, ku janë investuar rreth 80.000 € dhe tani po e shkatërron uji?

Laura Zherka, pyetje për Kryetarin, lidhur me vendosjen e flamujve për festën e 28 Nëntorit:

- Përzgjedhja për zbukurimin e qytetit për këtë festë ka qenë kuantiteti, kualiteti i flamujve, apo kreativiteti?

Teuta Krasniqi shtoi pyetjen: A është caktuar lokacioni për ndërtimin e objektit të shkollës së muzikës “Prenk Jakova”?

Naime Osmani ngriti një shqetësim, duke cekur se me rastin e mbajtjes së diskutimit publik në fshatin Besi lidhur me çerdhen, si pjesëmarrëse në atë takim dhe njëherësh anëtare e Kuvendit, dhe si përfaqësuese e deleguar e asaj pjese, nuk gjendem në fotografi në ueb-faqen e Komunës.

Në atë takim u kërkua që të organizohet një lloj diskutimi publik me drejtorin e Infrastrukturës Lokale, me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe me ndonjërin nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Lidhur me pyetjet e parashtruara dhe disa çështje të tjera që u potencuan nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Kryetari, z. Shpend Ahmeti**.

Pika e dhjetë
Të ndryshme

Ylli Hoxha kërkoi nga Kuvendi të bëhet një deklaram i përbashkët politik, lidhur me shqetësimin e një anëtari të Kuvendit nga një qytetar, që ka të bëjë me diskutimin e tij për zgjidhjen e çështjes së pronave në lagjen "Dodona".

Sami Hamiti tha se është rast për keqardhje, por përderisa çështje të tilla nuk ka pasur brenda për brenda në Kuvend, nuk e shoh të arsyeshme që të deklarohejm, e nëse vërtetë ka diçka me z. Pacolli, ai duhet t'i drejtohet instancave të tjera.

Islam Pacolli tha se ne jemi të thirrur dhe kemi ardhur me votën e qytetarit, kështu që me vjen keq që përmendet emri im, por fakti ka qenë kështu, nuk kam dashur të shkojë në polici, por me e informuar vetëm Kryetarin që sot, tani e mora një kërcënim nga një qytetar.

Qëndron Kastrati theksoi se ky shqetësim duhet të ngrihet këtu në Kuvend, sepse ka të bëjë me vendimmarrjen në Kuvendin komunal, edhe nuk mundemi ne me qëndruar indiferent ndaj pretendimit të kërcënimit ndaj njëres palë, se realisht ne po rrezikohemi të gjithë. Ne duhet të gjithë të angazhohemi që ky Kuvend me pasur lirinë e shprehjes dhe lirinë e vendimmarrjes.

Kryesuesi tha se parimisht jemi kundër çdo kërcënimi që mund t'u bëhet anëtarëve të Kuvendit lidhur me punën e Kuvendit, por nëse z. Pacolli është i kërcënuar, janë organet tjera që merren me këto punë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.